



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr. 2543/11 prot

Datë 16.02.2023

**V E N D I M**

**Nr. 120/2023**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 16.02.2023shqyrtoi ankesën me:

**Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Infosoft Office” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-35893-07-08-2022, me objekt: Loti I “Blerje Letër fotokopje A4, Letër fotokopje A3” me fond limit 28.918.530 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 21.10.2022 nga autoriteti kontraktor, Posta Shqiptare SHA.

**Autoriteti Kontraktor :** Posta Shqiptare SHA  
*Rruga “Reshit Çollaku”, Nr. 4, Tiranë*

**Ankimues:** Operatori ekonomik “Interlogistic” SHPK  
*Adresa: Autostrada Tiranë-Durrës, Rruga Dytësore Km 9, Godine 3 katëshe, Kashar, Tiranë.*

**Subjekt i Interesuar:** Operatori ekonomik “Infosoft Office” SHPK  
*Adresa: Autostrada Tiranë-Durrës, KM 8, Kashar, Tiranë*

**Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e

*Komisionit të Prokurimit Publik*". Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 "Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID - 19".

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim dhe pretendimet e ankimuesve dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

## **V ë r e n:**

### **I**

#### *Vlerësimi paraprak*

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik" dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomikë kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 "Për prokurimin publik".

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

### **II**

#### *Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 12.07.2022 në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit "Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar", me Nr. REF-35893-07-08-2022, me objekt: Loti I "Blerje Letër fotokopje A4, Letër fotokopje A3" me fond limit 28.918.530 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 21.10.2022 nga autoriteti kontraktor, Posta Shqiptare SHA.

II.2. Në datën 21.10.2022 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt ankimi.

II.3. Në datën 04.11.2022, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. “Infosoft Office” SHPK	19.910.738,75 lekë,	kualifikuar
2. “Interlogistic” SHPK	20.503.000 lekë,	kualifikuar
3. “Librari Dyrrahu” SHPK	23.422.500 lekë	skualifikuar
4. “Marketing & Distribution” SHPK	28.627.500 lekë,	kualifikuar

II.4. Në datën 14.11.2022, është publikuar Njoftimi i Fituesit në Sistemin e Prokurimit Elektronik, ku fitues rezulton operatori ekonomik “Infosoft Office” SHPK

II.5. Në datën 16.11.2022 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2022/2691 dhe me nr. 2543/2022 protokollin e operatorit ekonomik “Interlogistic” SHPK për procedurën e mësipërme të prokurimit.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Infosoft Office” SHPK ku pretendon se:

*“[...]Sa më sipër dhe bazuar në njohuritë dhe eksperiencën tonë profesionale, ne besojmë dhe jemi të bindur, që OE Infosoft shpk nuk ka paraqitur / depozituar në sistemin SPE të APP, Skedën teknike të "prodhuesit" e cila duhet të jetë një skedë teknike e certifikuar nga prodhuesi ose distributori i autorizuar, në përmbushje të kriterit të përcaktuar në DST. Në bindjen tonë (e cila mbështetet në eksperiencat tona konkurruese disa vjeçare me këtë operator ekonomik), OE Infosoft shpk ka paraqitur thjesht një tabelë të përgatitur mekanikisht nga vetë ofertuesi, në cilësinë e e distributorit të autorizuar, e cila nuk mund të konsiderohet kurrësi një Skedë Teknike e "prodhuesit" (ose ekuivalente), dhe rrjedhimisht nuk tregon testimin real të kryer nga ana e laboratorit të prodhuesit ose distributorit duke mos përmbushur specifikimet teknike të kerkuara për mallin objekt kontrate. Veprim i cili mund të verifikohet fare lehtë nga e ana e grupit të shqyrtimit të ankesës nëpërmjet krijimit të kontaktit me prodhuesin ose ekspertizës së posaçme të kësaj skede me prodhuesin ose distributorin. Duke parë edhe praktiken e Komisionit të Prokurimit Publik konkretisht vendimi nr. 377/2020 kuanëtarët e komisionit përpara se të dalin me një vendim mbajnë korrespondencë me prodhuesit e produkteve dhe jo me operatorët ofertues për të verifikuar dokumentet që nxjerrin për llogari të të furnizuarit edhe komisioni i vlerësimit të ofertave duhej të mbante një korrespondencë me prodhuesin ose distributorin e autorizuar për të verifikuar nëse skeda e dorëzuar nga "InfosoftOffice" shpk është certifikuar nga laboratorët e prodhuesit ose distributorit të autorizuar dhe të mos mjaftojë vetëm me paraqitjen në mënyrë fizike të skedës e cila është e fabrikuar në mënyrë mekanike. Gjithashtu Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime lidhur me përmbushjen e kërkesave të autoritetit kontraktor për sa i përket specifikimeve teknike për “Letër fotokopje A4” dhe për këtë kërkohet testimi i mostrave të dorëzuara, sipas parametrave të kërkuar në DST, për sa i përket gramaturës së letrës.*

I. Letër fotokopje A4

- Cilësi e parë me certifikatë ISO
- Gramatura nominale, 80gr/m2 dhe një rizëm (500fije x A4)
- Përmasat: 210 x 297 mm
- Pështa bazë 80gr/m2
- Lagështira: 3.0 - 4.0%

- *Trashësia : 103-110 µm*
- *Lëmueshmëria e sipërfaqes TS 60-125 ml/min*
- *Lëmueshmëria e sipërfaqes BS 90-150 ml/min*
- *Ashpërsia në përkulje:MD >110mN*
- *Ashpërsia në perkulje:CD >50mN*
- *Patejdukshmëria >94%*
- *Shkëlqimi: 108 - 111%*
- *Bardhësia CIE 161-165 [...]*

II.6 Në përputhje me nenin 112 “*Veprimet paraprake*” të Ligjit nr.162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. 2543/2 prot., datë 17.11.2022 me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues në lidhje me kriteret që nuk përmbushen nga operatori ekonomik pjesëmarrës në procedurën e “*Infosoft Office*” SHPK.

II 7Me shkresën nr. 1637/60 prot., datë 05.12.2022, protokolluar me tonën me nr. 2543/4 prot., datë 07.12.2022 me objekt “*Shqyrtim ankese*” është depozituar nga autoriteti kontraktor në Komisionin e Prokurimit Publik akti mbi trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues “*Interlogistic*” SHPK, lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit, nga ku rezulton se autoriteti kontraktor ka vendosur mospranimin e ankesës.

II.8 Me shkresën nr. 1637/61 prot., datë 06.12.2022, protokolluar me tonën me nr. 2543/5 prot., datë 07.12.2022 është depozituar nga autoriteti kontraktor në Komisionin e Prokurimit Publik dokumentacioni me objekt “*Informacion mbi procedurën e prokurimit me objekt Loti i I-rë “Blerje letër fotokopje A4, Letër fotokopje A3”*” lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.9 Me shkresën nr. 2543/6 prot., datë 06.01.2023 Komisioni i Prokurimit Publik i kërkoi autoritetit kontraktor, si më poshtë vijon “*Sa më sipër, referuar pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues, krahasinformacionit të mësipërm, KPP kërkon nga autoriteti juaj të dorëzoni pranë institucionittonë mostrat e paraqitura për këtë procedurë prokurimi, nga operatori ekonomik "Infosoft Office" SHPK, së bashku me dokumentacionin shoqërues të tyre, si dhe procesverbalin e mbajtur nga autoriteti kontraktor për administrimin e tyre.Sa më sipër, me qëllim vijimin e gjykimit të ankesës pranë Komisionit të ProkurimitPublik, i gjithë informacioni dhe dokumentacioni i sipërcituar të dorëzohet pranë KPP-së, brenda ditës së nesërme të punës, nga marrja dijani e kësaj shkrese”.*

II.10 Me shkresën nr. 1637/69 prot., datë11.01.2023 , protokolluar me tonën me nr. 2543/7 prot., datë 11.01.2023 është depozituar nga autoriteti kontraktor në Komisionin e Prokurimit Publik dokumentacioni me lëndë “*Paraqitje mostrash të operatorit ekonomik "InfoSoft Office" sh.p.k. për procedurën e prokurimit me objekt: Loti i I-rë: "Blerje Letër fotokopje A4, Letër fotokopje A3"*”.

II.11 Me shkresën nr. 1637/71 prot., datë 18.01.2023, protokolluar me tonën me nr. 2543/8 prot., datë 19.01.2023 është depozituar nga autoriteti kontraktor në Komisionin e Prokurimit Publik shkresa me lëndë “*Kerkese per vendimarrje*”.

II.12 . Për shkak të specifikës së kësaj procedure prokurimi, KPP konstaton, se për sqarimin e fakteve dhe pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues, të papranuara nga autoriteti kontraktor konkretisht në lidhje me specifikimet teknike të mostrës, kërkohen njohuri të posaçme teknike nga laborator të specializuar për kryerjen e testimit të letrës A4. Ndaj KPP për një gjykim të drejtë dhe transparent të ankesës, vlerëson të kryhet veprimi procedural të testimit të mostrave të dorëzuara nga operatorit ekonomik “*Infosoft Office*” ShPK në përputhje me specifikimet teknike, referuar pretendimeve të ngritura nga operatorit ekonomik ankimues “*Interlogistic*” SHPK, me qëllim asistimin e Komisionit të Prokurimit Publik, për gjykimin sa më të drejtë të ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II.12.1 Në përgjigje të shkresës së Komisionit të Prokurimit Publik me nr. 641/11 prot., datë 04.05.2022, me objekt: “*Kërkesë për informacion*”, Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit me shkresën nr. 185/1 prot., datë 09.05.2022 informon se: “[...] laboratorit i vetëm i akredituar prej saj për testimin e letrës dhe kartonit është *Eko-Studio Projekt SHPK me adresë: Bulevardi “Gjergj Fishta”, Nr.48, Tiranë*”. Gjithashtu, nga korrespondeca me email me Drejtorinë e Përgjithshme të Akreditimit, në datë 27.12.2022, kjo e fundit deklaron se “*Në përgjigje të e-mail “Kërkesë për informacion” të dërguar nga Komisioni i Prokurimit Publik në datë 22.12.2022 ju bëjmë me dije se deri më tani Laboratori i akredituar për kryerjen e testeve të letër/karton është laboratorit EKO-Studio Projekt shpk me certifikate akreditimi nr.LT 070.*”

II 12.2 . Me shkresën nr. 2710/7 prot., datë 17.01.2023 Komisioni i Prokurimit Publik i kërkoi informacion shoqërisë “*Eko-Studio Projekt*” SHPK, si më poshtë vijon:  
“[...]Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime lidhur me përmbushjen e kërkesave të autoritetit kontraktor për sa i përket specifikimeve teknike për “*Letër fotokopje A4*” dhe për këtë kërkohet testimi i mostrave të dorëzuara, sipas parametrave të kërkuar në DST, për sa i përket gramaturës së letrës.

I. *Letër fotokopje A4*

- *Cilësi e parë me certifikatë ISO*
- *Gramatura nominale, 80gr/m2 dhe një rizëm (500fije x A4)*
- *Përmasat: 210 x 297 mm*
- *Pesha bazë 80gr/m2*
- *Lagështira: 3.0 - 4.0%*
- *Trashësia : 103-110 µm*
- *Lëmueshmëria e sipërfaqes TS 60-125 ml/min*
- *Lëmueshmëria e sipërfaqes BS 90-150 ml/min*
- *Ashpërsia në perkulje:MD >110mN*
- *Ashpërsia në perkulje:CD >50mN*
- *Patejdukshmëria >94%*
- *Shkëlqimi: 108 - 111%*
- *Bardhësia CIE 161-165*

[...]

Sqarojmë se, në përgjigje të shkresës së Komisionit të Prokurimit Publik me nr. 641/11 prot., datë 04.05.2022, me objekt: “Kërkesë për informacion”, Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit me shkresën nr. 185/1 prot., datë 09.05.2022 informon se: “[...] laboratori i vetëm i akredituar prej saj për testimin e letrës dhe kartonit është Eko-Studio Projekt SHPK me adresë: Bulevardi “Gjergj Fishta”, Nr.48, Tiranë”. Gjithashtu, nga korrespondenca me email me Drejtorinë e Përgjithshme të Akreditimit, në datë 27.12.2022, kjo e fundit deklaroi se “Në përgjigje të e-mail “Kërkesë për informacion” të dërguar nga Komisioni i Prokurimit Publik në datë 22.12.2022 ju bëjmë me dije se deri më tani Laboratori i akredituar për kryerjen e testeve të letër/karton është laboratori EKO-Studio Projekt shpk me certifikate akreditimi nr.LT 070.”

Sa më sipër, në zbatim të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, kërkojmë informacion nëse kompania juaj është e profilizuar ose jo për të kryer vlerësimin teknik të parametrave të kërkuar më sipër, me qëllim verifikimin e përputhshmërisë së tyre me specifikimet teknike të përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet standarde të tenderit. Gjithashtu kërkojmë nga ana juaj të na informoni mbi koston apo tarifat, të cilat do të mbulohen nga ankimuesit.”

II.12.3 Në datën 25.01.2023 është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 2710/8 prot., shkresa e shoqërisë “Eko-Studio Projekt” SHPK me nr. 47 prot., datë 23.01.2023 me objekt: “Kthim përgjigje shkresës me nr. 2710/7 prot., datë 17.01.2023”. Me anë të kësaj shkrese KPP bëhet me dije se:

“[...] Eko Studio Projekt SHPK ka në përbërje Laborator të Akredituar dhe të kompletuar me instrumenta të standardeve bashkëkohore dhe efikase dhe kryen testim permanent dhe me kampione të komponentëve ndër të tjerë dhe të [...] letrës dhe kartonit.”

Për kryerjen e matjeve laboratorike Eko – Studio –Projekt është e pajisur me Certifikatë Akreditimi me numër Regjistrimi LT 070, konformë standartit S SH ISO/IEC 17025:2017, të lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit, në përputhje me ligjin Nr. 116/2014 “Për Akreditimin e Organeve të Vlerësimit të Konformitetit në Republikën e Shqipërisë”.

Në vijim tabela me standardet e provës dhe të mostrimit dhe sqarimin se:

<i>Letër – Karton – Brum Letre</i>				
<i>Nr.</i>	<i>Emertimi Proves</i>	<i>Fusha Provës</i>	<i>Standarti Proves</i>	<i>Standarti Mostrimit</i>
1.	<i>Densiteti</i>	<i>70 µm – 180 µm</i>	<i>SSH EN ISO 534:2011</i>	<i>SSH EN ISO 186:2002</i>
2.	<i>Gramatuara</i>	<i>0g-120g 0g-2000g</i>	<i>SSH ISO 536:2020</i>	<i>SSH EN ISO 186:2002</i>
3.	<i>Trashësia</i>	<i>70 µm – 180 µm</i>	<i>SSH EN ISO 534:2011</i>	<i>SSH EN ISO 186:2002</i>
4.	<i>Volum Specifik</i>	<i>70 µm – 180 µm</i>	<i>SSH EN ISO 534:2011</i>	<i>SSH EN ISO 186:2002</i>

“Kryejmë edhe testim dhe matje të komponentëve të letrës dhe kartonit sipas standardeve të përcaktuara në vijim:

<i>Letër – Karton – Brum Letre</i>				
<i>Nr.</i>	<i>Emertimi Proves</i>	<i>Fusha Provës</i>	<i>Standarti Proves</i>	<i>Standarti Mostrimit</i>
1.	<i>Ashpërsia/Lëmueshmëria</i>	<i>5ml/min-3000 ml/min</i>	<i>ISO 8791-2:2013</i>	<i>ISO 186:2002</i>
2.	<i>Ashpërsia/Lëmueshmëria</i>	<i>5ml/min-5000 ml/min</i>	<i>ISO 8791-2:2013</i>	<i>ISO 186:2002</i>
3.	<i>Bardhësia</i>	<i>L:0-100</i>	<i>ISO 11475:2017 ISO 2470-1:2016</i>	<i>ISO 186:2002</i>
4.	<i>Faktori i shperndarjes se ndricimit</i>	<i>L:0-100</i>	<i>ISO 2469:2007</i>	<i>ISO 186:2002</i>
5.	<i>Tejdukshmeria</i>	<i>CIE illuminant C</i>	<i>SSH ISO 2471-1:2008</i>	<i>ISO 186:2002</i>
6.	<i>Mbetje hirit</i>	<i>0.2% - 100 %</i>	<i>SSH ISO 2144:2019</i>	<i>ISO 186:2002</i>
7.	<i>pH</i>	<i>4-10</i>	<i>SSH ISO 6588-1:2021</i>	<i>ISO 186:2002</i>
8.	<i>Alkalinitetit</i>	<i>0.07-2 mol/kg CaCO3</i>	<i>SSH ISO 10716:2022</i>	<i>ISO 186:2002</i>

“Për kryerjen e testimeve dhe fiksimit të rezultateve duhet të dërgohen në ambientet e laboratorit kampione përfaqësues në mjediset e laboratorit.

<i>Nr.</i>	<i>Shërbim</i>	<i>Njësia</i>	<i>Sasia</i>	<i>Cmimi në lek pa TVSH</i>
1.	<i>Analiza gramaturës</i>	<i>Copë/një testim</i>	<i>1</i>	<i>6600</i>

II.12.4. Gjithashtu, në datën 06.02.2023 është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 2710/9 prot., shkresa e shoqërisë “Eko-Studio Projekt” SHPK me nr. 47/2 prot., datë 23.01.2023 me objekt: “Kthim përgjigje shkresës me nr. 2710/7 prot., datë 17.01.2023”. Me anë të kësaj shkrese KPP bëhet me dije se:

“[...] Eko Studio Projekt SHPK ka në përbërje Laborator të Akredituar dhe të kompletuar me instrumenta të standardeve bashkëkohore dhe efikase dhe kryen testim permanent dhe me kampione të komponentëve ndër të tjerë dhe të [...] letrës dhe kartonit.”

Për kryerjen e matjeve laboratorike Eko – Studio –Projekt është e pajisur me Certifikatë Akreditimi me numër Regjistrimi LT 070, konformë standartit S SH ISO/IEC 17025:2017, të lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit, në përputhje me ligjin Nr. 116/2014 “Për Akreditimin e Organeve të Vlerësimit të Konformitetit në Republikën e Shqipërisë”.

Në vijim tabela me standardet e provës dhe të mostrimit dhe sqarimin se:

<i>Letër – Karton –</i>
-------------------------

<i>Brum Letre</i>				
<i>Nr.</i>	<i>Emertimi Proves</i>	<i>Fusha Provës</i>	<i>Standarti Proves</i>	<i>Standarti Mostrimit</i>
1.	<i>Densiteti</i>	<i>70 µm – 180 µm</i>	<i>SSH EN ISO 534:2011</i>	<i>SSH EN ISO 186:2002</i>
2.	<i>Gramatuara</i>	<i>0g-120g 0g-2000g</i>	<i>SSH ISO 536:2020</i>	<i>SSH EN ISO 186:2002</i>
3.	<i>Trashësia</i>	<i>70 µm – 180 µm</i>	<i>SSH EN ISO 534:2011</i>	<i>SSH EN ISO 186:2002</i>
4.	<i>Volum Specifik</i>	<i>70 µm – 180 µm</i>	<i>SSH EN ISO 534:2011</i>	<i>SSH EN ISO 186:2002</i>

“Kryejmë edhe testim dhe matje të komponentëve të letrës dhe kartonit sipas standardeve të përcaktuara në vijim:

<i>Letër – Karton – Brum Letre</i>				
<i>Nr.</i>	<i>Emertimi Proves</i>	<i>Fusha Provës</i>	<i>Standarti Proves</i>	<i>Standarti Mostrimit</i>
1.	<i>Ashpërsia/Lëmueshmëria</i>	<i>5ml/min-3000 ml/min</i>	<i>ISO 8791-2:2013</i>	<i>ISO 186:2002</i>
2.	<i>Ashpërsia/Lëmueshmëria</i>	<i>5ml/min-5000 ml/min</i>	<i>ISO 8791-2:2013</i>	<i>ISO 186:2002</i>
3.	<i>Bardhësia</i>	<i>L:0-100</i>	<i>ISO 11475:2017 ISO 2470-1:2016</i>	<i>ISO 186:2002</i>
4.	<i>Faktori i shperndarjes se ndricimit</i>	<i>L:0-100</i>	<i>ISO 2469:2007</i>	<i>ISO 186:2002</i>
5.	<i>Tejdukshmeria</i>	<i>CIE illuminant C</i>	<i>SSH ISO 2471-1:2008</i>	<i>ISO 186:2002</i>
6.	<i>Mbetje hirit</i>	<i>0.2% - 100 %</i>	<i>SSH ISO 2144:2019</i>	<i>ISO 186:2002</i>
7.	<i>pH</i>	<i>4-10</i>	<i>SSH ISO 6588-1:2021</i>	<i>ISO 186:2002</i>
8.	<i>Alkalinitetit</i>	<i>0.07-2 mol/kg CaCO3</i>	<i>SSH ISO 10716:2022</i>	<i>ISO 186:2002</i>

[...]

“Për kryerjen e testeve dhe fiksimit të rezultateve duhet të dërgohen në ambientet e laboratorit kampionet përfaqësues në mjediset e laboratorit.

Oferta ekonomike është si vijon:

<i>Nr.</i>	<i>Shërbim</i>	<i>Njësia</i>	<i>Sasia</i>	<i>Cmimi në lek pa TVSH</i>
1.	<i>Analiza gramaturës</i>	<i>Copë/një testim</i>	<i>1</i>	<i>6600</i>
2.	<i>Trashësia</i>	<i>Copë/një testim</i>	<i>1</i>	<i>5720</i>



[...]

v.o Në cmimet e mësipërme është përfshirë përgatitja e kampionit sipas standardeve të mostrimit si dhe kryerja e testimit dhe nxjerrja e rezultatit.”

II.13 Sa më sipër Komisioni i Prokurimit Publik me vendimin **Nr. 85/2023**, datë 07.02.2023 ka vendosur:

1. Të urdhëroj kryerjen e ekspertizës për analizimin e mostrës të paraqitur nga operatori ekonomik “Infosoft Office” SHPK sipas metodës/standartit të kërkuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat standarte të tenderit nga laboratorin e akredituar i shoqërisë “Eko-Studio Projekt” SHPK, nëse mostra e paraqitur është në përputhje me specifikimet teknike të paraqitura nga operatori ekonomik “Infosoft Office” SHPK “Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-35893-07-08-2022, me objekt: Loti I “Blerje Letër fotokopje A4, Letër fotokopje A3” me fond limit 28.918.530 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 21.10.2022 nga autoriteti kontraktor, Posta Shqiptare SHA.
2. Operatori ekonomik “Interlogistic” SHPK, të parapaguajë për llogari të shoqërisë “Eko-Studio Projekt” SHPK, shumën prej 12.320 lekë pa tvsh si tarifë e përcaktuar me anë të shkresës nr. 47/2 prot., datë 23.01.2023, protokolluar pranë KPP me nr.2710/9 prot., datë 06.02.2023, për testimin e mostrave dhe të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik, së bashku me kopje të faturës financiare të parapagimit, brënda datës 10.02.2023 ora 09:00.
3. Në datën 10.02.2023 ora 09:00, të paraqiten pranë Komisionit të Prokurimit Publik përfaqësues të autoritetit kontraktor Posta Shqiptare SHA dhe përfaqësues të operatorëve ekonomikë “Infosoft Office” SHPK, dhe “Interlogistic” SHPK me autorizim të posaçëm, të cilët në prani të Komisionit të Prokurimit Publik do të dorëzojnë mostrat për testim në laboratorin e akredituar pranë shoqërisë “Eko-Studio Projekt” SHPK.
4. Të njoftojë laboratorin e shoqërisë “Eko-Studio Projekt” SHPK për kryerjen e testimit të mostrave në datën dhe orën e përcaktuar.
5. Afati për kthimin e përgjigjes së testimit brenda datës 14.02.2023.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

II.14 Në datën 10.02.2023 u zhvillua seanca e verifikimit/dëgjimit audio në sistemin e ankesave elektronike nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik, me përfaqësues të operatorit ekonomik subjekt i interesuar dhe autoritetit kontraktor. Seanca u regjistrua në formë audio.

II.12. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ rezulton, se nuk ka operatorë ekonomikë të interesuar në këtë procedurë prokurimi, konkretisht në përputhje me nenin 113 të LPP-së.

### III

#### Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dhe dokumentacionit bashkëngjitur saj,

**Arsyeton**

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Interlogistic ” SHPK mbi për kualifikimin e ofertës se paraqitur nga operatori ekonomik “Infosoft Office’ SHPK se[...]Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime lidhur me përmbushjen e kërkesave të autoritetit kontraktor për sa i përket specifikimeve teknike për “Letër fotokopje A4” dhe për këtë kërkohet testimi i mostrave të dorëzuara, sipas parametrave të kërkuar në DST, për sa i përket gramaturës së letrës.

I. *Letër fotokopje A4*

- *Cilësi e parë me certifikatë ISO*
- *Gramatura nominale, 80gr/m2 dhe një rizëm (500fije x A4)*
- *Përmasat: 210 x 297 mm*
- *Pesha bazë 80gr/m2*
- *Lagështira: 3.0 - 4.0%*
- *Trashësia : 103-110 µm*
- *Lëmueshmëria e sipërfaqes TS 60-125 ml/min*
- *Lëmueshmëria e sipërfaqes BS 90-150 ml/min*
- *Ashpërsia në perkulje:MD >110mN*
- *Ashpërsia në perkulje:CD >50mN*
- *Patejdukshmëria >94%*
- *Shkëlqimi: 108 - 111%*
- *Bardhësia CIE 161-165*

[...]

II.1.2 Sa më sipër Komisioni i Prokurimit Publik me vendimin **Nr. 85/2023**, datë 07.02.2023 ka vendosur:

1. *Të urdhëroj kryerjen e ekspertizës për analizimin e mostrës të paraqitur nga operatori ekonomik “Infosoft Office” SHPK sipas metodës/standartit të kërkuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat standarte të tenderit nga laborator i akredituar i shoqërisë “Eko-Studio Projekt” SHPK, nëse mostra e paraqitur është në përputhje me specifikimet teknike të paraqitura nga operatori ekonomik “Infosoft Office” SHPK “Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-35893-07-08-2022, me objekt: Loti I “Blerje Letër fotokopje A4, Letër fotokopje A3” me fond limit 28.918.530 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 21.10.2022 nga autoriteti kontraktor, Posta Shqiptare SHA.*
2. *Operatori ekonomik “Interlogistic” SHPK, të parapaguajë për llogari të shoqërisë “Eko-Studio Projekt” SHPK, shumën prej 12.320 lekë pa tvsh si tarifë e përcaktuar me anë të shkresës nr. 47/2 prot., datë 23.01.2023, protokolluar pranë KPP me nr.2710/9 prot., datë 06.02.2023, për testimin e mostrave dhe të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik, së bashku me kopje të faturës financiare të parapagimit, brënda datës 10.02.2023 ora 09:00.*
3. *Në datën 10.02.2023 ora 09:00, të paraqiten pranë Komisionit të Prokurimit Publik përfaqësues të autoritetit kontraktor Posta Shqiptare SHA dhe përfaqësues të operatorëve ekonomikë “Infosoft Office” SHPK, dhe “Interlogistic” SHPK me autorizim të posaçëm, të cilët në prani të Komisionit të Prokurimit Publik do të dorëzojnë mostrat për testim në laboratorin e akredituar pranë shoqërisë “Eko-Studio Projekt” SHPK.*

4. Të njoftojë laboratorin e shoqërisë “Eko-Studio Projekt” SHPK për kryerjen e testimin të mostrave në datën dhe orën e përcaktuar.
5. Afati për kthimin e përgjigjes së testimin brenda datës 14.02.2023.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Në përputhje me nenin 24 pika 3 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: “Në marrjen e vendimeve mban parasysht, përveç parimeve të përgjithshme të përmendura në nenin 3 të këtij ligji, edhe parimet e mëposhtme: paanshmërinë në shqyrtimin e ankesave, qëndrueshmërinë në vendimmarrje, ligjshmërinë, shpejtësinë dhe efikasitetin, aksesin, karakterin publik, si edhe parimin e kontradiktoritetit.” Komisioni, në jurisprudencën e tij, e ka bërë pjesë të standardeve për një proces të rregullt ligjor edhe respektimin e parimit të kontradiktoritetit. Për sa më sipër, parimi i kontradiktoritetit, i parë në këndvështrimin e barazisë së armëve në procesin administrativ, është një evolucion logjik i të drejtës së palës për të marrë pjesë në gjykim dhe për t’u trajtuar në mënyrë të drejtë dhe të barabartë nga një gjyqtar (arbitër) i drejtë dhe i paanshëm, i cili u garanton të dyja palëve të njëjtat mundësi, për të shpalosur provat dhe argumentet e tyre. Nëse nuk do të ekzistonte barazia e armëve në shqyrtimin administrativ, atëherë argumentet e njërës palë do të prevalonin mbi argumentet e palës së cenuar dhe për rrjedhojë, e drejta për të marrë pjesë në gjykim do të zhvishej nga funksioni i saj kushtetues dhe ligjor për të garantuar një proces të rregullt ligjor. Ndaj për këtë qëllim, Komisioni organizoi një seancë dëgjimore mes palëve në lidhje me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues.

III.1.2 Ne datën 10.02.2023 u zhvillua seanca verifikimit/dëgjimit audio në sistemin e ankesave elektronike nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik, me përfaqësues të operatorit ekonomik subjekt i interesuar dhe autoritetit kontraktor. Seanca u regjistrua në formë audio. Në seancën dëgjimore morën pjesë përfaqësuesit e Autoritetit Kontraktor, si dhe përfaqësuesi i Operatorit ekonomik ankimues “Infosoft Office” SHPK, por jo përfaqësuesi i operatorit ekonomik ankimues.

Në ankesën e depozituar pranë KPP-së, operatori ekonomik ngre pretendime për ekspertizën e letres se dorezuar në formën e mostres nga operatori ekonomik “Infosoft Office” SHPK me pretendimin për “Letër fotokopje A4” dhe për këtë kërkohet testimi i mostrave të dorëzuara, sipas parametrave të kërkuar në DST, për sa i përket gramaturës së letrës.

Referuar kesaj të fudnit në vendimin e ndermjetem me nr 85/2023 u vendos:

1. Operatori ekonomik “Interlogistic” SHPK, të parapaguajë për llogari të shoqërisë “Eko-Studio Projekt” SHPK, shumën prej 12.320 lekë pa tvsh si tarifë e përcaktuar me anë të shkresës nr. 47/2 prot., datë 23.01.2023, protokolluar pranë KPP me nr.2710/9 prot., datë 06.02.2023, për testimin e mostrave dhe të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik, së bashku me kopje të faturës financiare të parapagimit, brenda datës 10.02.2023 ora 09:00.
2. Në datën 10.02.2023 ora 09:00, të paraqiten pranë Komisionit të Prokurimit Publik përfaqësues të autoritetit kontraktor Posta Shqiptare SHA dhe përfaqësues të operatorëve ekonomikë “Infosoft Office” SHPK, dhe “Interlogistic” SHPK me autorizim të posaçëm, të cilët në prani të Komisionit të Prokurimit Publik do të dorëzojnë mostrat për testim në laboratorin e akredituar pranë shoqërisë “Eko-Studio Projekt” SHPK.

Operatori ekonomik ankimues nuk u paraqit si palë ankimuese dhe referuar Kodit të Procedurës administrative në Nenin 94 në pikën 3 dhe 4 citohet se “3. Në çdo rast, tërheqja e kërkesës apo braktisja e procedurës nuk ndikon në vazhdimin e tij, nëse organi publik çmon se vazhdimi i procedurës është në interes publik, me përjashtim të rasteve kur procedura është e tillë që mund të fillojë vetëm me kërkesën e palës. 4. Procedura deklarohet e braktisur pa një vendim përfundimtar për çështjen, në qoftë se pala e interesuar, për fajin e saj, ka qenë pasive gjatë afatit për përfundimin e procedurës administrative të parashikuar në nenin 91 të këtij Kodi.”, akoma me tej ne mungesë të tij nuk u paraqit dhe mandati i pagesës për testimin e mostres ku ne baze të rregullores së brendshme neni 25 Shpenzimet procedurale.

1. Shpenzimet procedurale përfshijnë tarifën e ankesës dhe shpenzimet për konsultimin/ekspertizën e specialistëve/ekspertëve të pavarur.

2. Kur Komisioni, në procesin e shqyrtimit të një ankesë, urdhëron thirrjen e specialistëve ose të ekspertëve dhe kryerjen e ekspertizës, duhet të përcaktojë detyrimin e palëve për parapagimin e tyre dhe afatin.

3. Parapagimi i shpenzimeve vërtetohet duke paraqitur dokumentacionin bankar përkatës.

4. Palët në proces mbulojnë shpenzimet e ekspertizës.

5. Komisioni përcakton në vendimin që përfundon procedimin administrativ edhe detyrimin, se kujt i ngarkohen shpenzimet procedurale. ,

KPP gjykon se pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk do merret parasysh pasi operatori ekonomik ankimues duhet të permbushë gjitha detyrimet, për të cilat në ankesë ai vetë ka kërkuar ekspertizë në lidhje me testimin e letrës.

III.2 Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Interlogistic ” SHPK mbi për kualifikimin e ofertës se paraqitur nga operatori ekonomik “Infosoft Office’ SHPK se.[...]

Sa më sipër dhe bazuar në njohuritë dhe eksperiencën tonë profesionale, ne besojmë dhe jemi të bindur, që OE Infosoft shpk nuk ka paraqitur / depozituar në sistemin SPE të APP, Skedën teknike të "prodhuesit" e cila duhet të jetë një skedë teknike e certifikuar nga prodhuesi ose distributori i autorizuar, në përmbushje të kriterit të përcaktuar në DST. Në bindjen tonë (e cila mbështetet në eksperiencat tona konkurruese disa vjeçare me këtë operator ekonomik), OE Infosoft shpk ka paraqitur thjesht një tabelë të përgatitur mekanikisht nga vetë ofertuesi, në cilësinë e e distributorit të autorizuar, e cila nuk mund të konsiderohet kurrësi një Skedë Teknike e "prodhuesit" (ose ekuivalente), dhe rrjedhimisht nuk tregon testimin real të kryer nga ana e laboratorit të prodhuesit ose distributorit duke mospërmbushur specifikimet teknike të kerkuara për mallin objekt kontrate. Veprim i cili mund të verifikohet fare lehtë nga e ana e grupit të shqyrtimit të ankesës nëpërmjet krijimit të kontaktit me prodhuesin ose ekspertizës së posaçme të kësaj skede me prodhuesin osedistributorin. Duke parë edhe praktiken e Komisionit të Prokurimit Publik konkretisht vendimi nr. 377/2020 kuanëtarët e komisionit përpara se të dalin me një vendim mbajnë korrespondencë me prodhuesit e produkteve dhe jo me operatorët ofertues për të verifikuar dokumentet që nxjerrin për llogari të tëfurnizuarit edhe komisioni i vleresimit të ofertave duhej të mbante një korrespondencë meprodhuesin ose distributorin e autorizuar për të verifikuar nëse skeda e dorëzuar nga "InfosoftOffice" shpk është certifikuar nga laboratorët e prodhuesit ose distributorit të autorizuar dhe të mosmjaftojë vetëm me paraqitjen në mënyrë fizike të skedës e cila është e fabrikuar në mënyrë mekanike.[..] Komisioni prokurimit Publik verë;

III.2.1 Në shtojcën 7 “Kriteret e veçanta të kualifikimit” pika 2.3.5 “Kapaciteti teknik” të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

“2.3.5. Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi ose distributori i autorizuar, si dhe duhet të dorëzojë skedën teknike të certifikuar nga prodhuesi ose

distributori i autorizuar, ku të jenë të pasqyruara karakteristikat dhe specifikimet teknike të tij për produktin **Letër fotokopje A4, Letër fotokopje A3.**”

II.2.2 Në shtojcën 6 “Formulari i sasisë dhe grafikut të lëvrimit”, të dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, është përcaktuar si më poshtë:

### **Shtojca 6**

*(Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)*

*(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)*

#### **FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT**

**Sasia e mallit që kërkohet:**

**Loti i Parë: “Blerje Letër fotokopje A4, Letër fotokopje A3”,**

<i>Nr</i>	<i>EMËRTIMI</i>	<i>Njësia e matjes</i>	<i>Sasia e kërkuar</i>
<b>1</b>	<b>Letër fotokopje A4</b>	<b>kg</b>	<b>130,000</b>
<b>2</b>	<b>Letër fotokopje A3</b>	<b>Kuti</b>	<b>5</b>

**Loti i Dytë: “Letër A5 "Traktor" (3 kopje), Letër A4 "Traktor" (3 kopje)”**

<i>Nr</i>	<i>EMËRTIMI</i>	<i>Njësia e matjes</i>	<i>Sasia e kërkuar</i>
<b>1</b>	<b>Letër A5 "Traktor" (3 kopje)</b>	<b>fije</b>	<b>2,841,000</b>
<b>2</b>	<b>Letër A4 "Traktor" (3 kopje)</b>	<b>fije</b>	<b>8,109,000</b>

**Afatet e lëvrimit:** Për sejcilin nga lotet, afati i lëvrimit të mallit objekt kontrate, do të jetë jo më vonë se 3 (tre) muaj kalendarik, nga data e nënshkrimit të kontratës.

**Vendi i dorëzimit:** Për sejcilin nga lotet, Malli objekt kontrate do të dorëzohet në Magazinën e Drejtorisë së Shoqërisë Posta Shqiptare sh.a..

III.2.3. Neni 2 “Qëllimi i ligjit” 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se: Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

III.2.4 Neni 3 Parime të përgjithshme 1. *Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe vepronë me transparencë e në mënyrë proporcionale.* 2. *Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.* 3. *Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.*

III.2.5 . Neni 21 Autoriteti ose enti kontraktor 1. *Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi.*

III.2.6 Neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se:

*“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

*a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*

*b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*

*c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.*

*Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie”*

III.2.7. Në nenin 40 pika 1, 2 dhe 6 të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

*“1. Në procedurat e prokurimit për mallra, autoriteti/enti kontraktor parashikon sasinë e mallrave që do të lëvrojë, si dhe grafikun e lëvrimin të mallrave.*

*2. Për mallrat që do të prokurohen, autoritetet/entet kontraktore parashikojnë specifikimet teknike, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36, të LPP-së, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara.*

*3. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të*

*trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor.*

*Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose b) fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose c) dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.”.*

III.2.8 . Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se operatori ekonomik “Infosoft Office” SHPK në përmbushje të kriterit sa më sipër kanë dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Marreveshje midis Kompanis Naigator SA ku deklaron se Infosoft Office është Distributor i Autorizuar per Shqiperine per te gjitha produktet e prodhuara nga kompania Navigator SA.
- Certifikate leshuar nga Kompania Naigator vertetim se letrat permbushin standartet Iso 9706: 1994 me të dhënat e letrës.
- Deklaratë Doganore Datë 14.06.2022
- Skede Teknike e Letres A3 dhe A4 nga “ Infosoft Office” SHPK ku ne dokument citon se “Infosoft Office” SHPK ne cilësinë e distributorit te autorizuar të prodhuesit të Navigator Company S.A certifikon te dhenat”

III.2.9 . Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit ekonomik për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj, autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, me dokumentacionin e dorëzuar, duhet të vërtetojnë, që produkti i ofruar është në përputhje me parametrat dhe specifikimet teknike e kërkuara nga autoriteti kontraktor. Operatorët ekonomikë ofertues marrin përsipër përmbushjen e specifikimeve teknike të produkteve të përcaktuara në dokumentet e tenderit nga ana e autoriteteve kontraktore, nëpërmjet deklaratave dhe dokumentacionit provues në të cilin duhet të faktojnë përputhshmërinë e specifikimeve të mallrave/shërbimeve të ofertuara prej tyre me ato të

përcaktuara nga autoriteti kontraktor, në mënyrë që nga ana e këtij të fundit të mund të kryhet me lehtësi e saktësi vlerësimi i mallrave apo shërbimeve të ofertuara nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duke përzgjedhur atë ofertues i cili me dokumentacionin e dorëzuar garanton përputhshmërinë me specifikimet përkatëse të kërkuara në DT, e rrjedhimisht realizimin me sukses të kontratës objekt-prokurimi

III.2.10 . Referuar sa më sipër, Komisioni konstaton, se në dokumentet e procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar në pikën 2.3.5 kapaciteti teknik dokumentet që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë, nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomikë “Infosoft Office” SHPK në përmbushje të kriterit të veçantë të kualifikimit, pika 2.3.5 kapaciteti teknik. KPP konstaton, se ky i fundit, ka dorëzuar dokumentacionin e nevojshëm për përmbushjen e pikës 2.3.5 të përcaktuar në dokumentet standarde të tenderit në të cilin është shprehur qartë, se *Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi ose distributori i autorizuar, si dhe duhet të dorëzojë skedën teknike të certifikuar nga prodhuesi ose distributori i autorizuar, ku të jenë të pasqyruara karakteristikat dhe specifikimet teknike të tij për produktin **Letër fotokopje A4, Letër fotokopje A3**.* Nga analizimi i ofertës teknike të dorëzuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike (SPE), Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se operatori ekonomik ankimues, si pjesë të ofertës se tij, ka dorëzuar dokumentacion e kërkuar në dokumentet standarde të tenderit, për produktin që ka ofruar dhe që janë kërkuar të prokurohen nga ana e autoritetit kontraktor.

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se kërkesa e autoritetit kontraktor e përcaktuar në pikën 2.3.5 kapaciteti teknik i dokumenteve standarde të tenderit, është në përputhje me produktin e kërkuar në procedurën e prokurimit objekt-prokurimi, si dhe është një kërkesë e ligjshme e në përputhje me gërmën “b”, të pikës 6 të nenit 40 të VKM 285/2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*” i ndryshuar, në të cilën parashikohet se: “*Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: b) fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose.*”

Nga interpretimi telologjik (qëllimi i normës juridike) Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se kërkesa për dorëzimin e dokumentacionit të parashikuar në pikën 2.3.5 kapaciteti teknik i dokumenteve standarde të tenderit, është një kërkesë e argumentuar nga ana ligjore dhe që i shërben autoritetit kontraktor për krijimin e një panorame të qartë mbi përputhshmërinë e specifikimeve teknike të produktit/eve të ofruara nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës me specifikimet teknike të produktit/produkteve të kërkuara nga autoriteti kontraktor. Sa më sipër nga interpretimi në tërësi, duke iu referuar interpretimit gjuhësor dhe atij telologjik të dispozitës së mësipërme, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se dokumentacioni i dorëzuar nga operatori ekonomikë ankimues për përmbushjen e kriterit të parashikuar në pikën 2.3.5 kapaciteti teknik i dokumenteve standarde të tenderit, përmban të dhëna të qarta, dhe për sa kohë Operatori ekonomik Infosoft Office është distributori i autorizuar nga kompania Navigator Sa për produktin e kërkuar dhe skeda e nënshkruar nga operatori ekonomik përmban të njëjtën vlerë sikurse do ishte po ta kishtë leshuar kompania prodhuese që në rastin konkret është Navigator SA.

Përsa më sipër Operatori ekonomik “Infosoft Office” SHPK me anë të dokumentacionit të paraqitur, e plotëson kriterin e përcaktuar nga autoriteti kontraktor, në pikën 2.3.5 kapaciteti teknik i dokumenteve standarde të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-shqyrtimi.



Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomikë ankimues “Interlogistic” SHPK” nuk qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

### **Vendos:**

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Interlogistic” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-35893-07-08-2022, me objekt: Loti I “Blerje Letër fotokopje A4, Letër fotokopje A3” me fond limit 28.918.530 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 21.10.2022 nga autoriteti kontraktor, Posta Shqiptare SHA.
2. Autoriteti Kontraktor të vijoje me hapat e metejshëm të procedurës objekt ankimi.
3. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit të tarifës financiare të paguara nga operatorët ekonomikë “Interlogistic” SHPK.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

## **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Nënkryetar**  
**Fiorent Zguro**

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Kryetar**  
**Jonaid Myzyri**

